

Thirrja nga data 23.05.2024 deri në datën 30.05.2024

## TERMAT E REFERENCES

### PËR

### TRAJNER/E PËR OFRIMIN E TRAJNIMIT “EDUKIMI MEDIAL”

<b>Organizata</b>	<b>OJQ “NEVO KONCEPTI”</b>
<b>Objektiva</b>	Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimit në temën “Edukimi Medial” për anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF) në Prizren.

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershori ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftesi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

### 1. INFORMATAT TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

”Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedaze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve ne nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulta të komunës së Prizrenit.

*Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve.*

## 2. OBJEKTIVA

Mediat e lira, të sigurta, të pavarura dhe përgjegjëse janë themeli i zhvillimit të një shoqërie demokratike. Ata janë një lidhje e rëndësishme për ndërtimin e një shoqërie të zhvilluar, për përparim social, ekonomik dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ndigimi i mediave është një fenomen që ka ardhur duke u rritur falë përparimeve në teknologji. Shtrirja e gjerë e mediave brenda shoqërive të ndryshme e lejon që ata të mbajnë mesazhe pa kufizime hapësinore dhe kohore.

Duke përdorur atributet e saj kryesore, të cilat janë për të informuar, argëtuar dhe edukuar, media është e aftë të promovojë mendime, prirje dhe të modifikojë mënyrën në të cilën mund të klasifikohet një ngjarje ose temë. Radio, revista, gazeta, televizion, kinema, rrjete sociale janë disa nga mediat më të shpeshta dhe karakteristike sot. Përdorimi i faqeve të medias sociale sot konsiderohet një ndër aktivitetet më të zakonshme të fëmijëve dhe të adolescentëve. Për shkak të kapacitetit të tyre të kufizuar për vetë-rregullim dhe ndjeshmërisë ndaj presionit të bashkëmoshatarëve, fëmijët dhe adolescentët mund të gjenden në rrezik gjatë lundrimit dhe të eksperimentimit në mediat sociale. Nevo Koncepti kërkon një individë (trajnerë) për të ofruar dhe zhvilluar trajnimin një ditorë për fëmijët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve, grup mosha e fëmijëve 12 – 15 vjeçar/e.

## 3. Kualifikimi i kandidatit/ës

Trajneri/ja duhet të ketë aftësitë dhe njojurinë të nevojshme vijuese:

- Diplomë pasuniversitare (preferohet niveli Master) në shkencat shoqërore;
- 5-7 vjet përvjohje pune si trajner/e, duke përfshirë hartimin moduleve të trajnimit dhe ofrimin e programeve
- Shkaktësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve
- Njohuri dhe shkaktësi për të komunikuar dhe punuar me fëmijë dhe të rinj
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore
- Të jetë fleksibil për tu përshtatur me orarin e përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), për të caktuar ditën e trajnimit.
- Të jetë i/e aftë në komunikim me fëmijët, t'i mësoj dhe këshillojë fëmijët mbi temën.
- Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)
- Udhëheqë trajnimin me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse në pajtim me 9 rregullat për pjesëmarrje të sigurt dhe kuptimplotë të fëmijëve:  
<https://resourcecentre.savethechildren.net/document/nine-basic-requirements-meaningful-and-ethical-childrens-participation/>

**Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.**

#### 4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me 3 Qershori deri me 30 Qershori 2024. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Tituli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të trajnimit	Zhvillimi / adaptimi i programit të trajnimit, përfshirë matrialet e trajnimit, si dhe të formojë vlerësimin Pre Post Test për Edukimin Medial .	2	Qershori 2024
2	Ofrimi i programit të trajnimit për Asamblenë Komunale të Fëmijëve	Ofrimi i trajnimit 1-ditor për një grup të pjesëmarrësve	1	Qershori 2024
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimit i raportit përfundimtar mbi angazhimin në trajnimin Edukimi Medial.	1	Qershori 2024
<b>Gjithsej:</b>		<b>4</b>		

#### 5. REZULTATET E PRITSHME

- AKF të jetë e njojur me termet kryesore që ndërlidhen me “Edukimin Medial”
- AKF të ngrisë kapacitetet se sim und t’i shfrytëzojnë mediat për promovimin e punës së tyre.
- AKF të përfitojë njohuri praktike si të jenë qytetarë aktiv, si të ndërmarrin iniciativa sociale dhe si drejtohet institucioneve dhe mekanizmave të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ti parandalojnë rastet e keqëpërdorimit në media.

#### PROCEDURA E APLIKIMT

Të gjithë të interesuarit duhet t’i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologja e propozuar e mbajtjës së trajnimit.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 30.05.2024** në [e.qylangji@nevokoncepti.org](mailto:e.qylangji@nevokoncepti.org) duke e kopjuar (cc) në email [o.osmani@nevokonepti.org](mailto:o.osmani@nevokonepti.org)